
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data 24.03.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE ENË METALIKE DHE PLASTIKE PËR MARRJE
MOSTRE KARBURANTI, e ndarë në lote**

LOTI 1: ENË METALIKE PËR MARRJE MOSTRE KARBURANTI

LOTI 2: ENË PLASTIKE PËR MARRJE MOSTRE KARBURANTI

**MARRËVESHJE KUADËR ME DISA OPERATORE EKONOMIKË, KU TË GJITHA
KUSHTET JANË TË PËRCAKTUAR**

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 39221220-5 Enë, 39225710-5
Shishe

Vlera e fondit limit: Fondi limit total i marrëveshjes kuadër është 7,391,070 (shtatë milion e
treqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, e ndarë në lote,

Loti 1: Enë metalike për marrje mostre karburanti, me fond limit në vlerën 4,151,070 (katër milion
e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH

Loti 2: Enë plastike për marrje mostre karburanti me fond limit në vlerën 3,240,000 (tre million e
dyqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2,
pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara
sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe
kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT: TË NJËJTA PËR TË GJITHA LOTET

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% **për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin

informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Bazuar në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se: “4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Bazuar në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se: “2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurrenca është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për**

të cilat konkurron. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

Bazuar në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/skedë teknike për artikujt objekt prokurimi për secilin lot që konkuron, ku të përfshihen emërtimet dhe specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me artikujt objekt prokurimi. Kataloget/skeda teknike të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “ *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;*”

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmërinë me specifikimet teknike e cila siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit për secilin lot që konkuron, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: “*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*” Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “*1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*” Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.
Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, si më poshtë:

LOTI 1. ENË METALIKE PËR MARRJE MOSTRE KARBURANTI

Emërtimi i artikujve	Specifikime teknike	
Enë metalike për marrje mostre karburanti	- Sasi të pritshme	➤ 28,000
	- Njësia	➤ Copë
	- Lëvrimi	- sipas Marrëveshjes Kuadër të parashikuar me afat : 24 (njëzet e katër) muaj, nëpërmjet minikontratave të lidhura sipas nevojës me afat lëvrimi 60 ditë
	- Vëllimi	- 1 (një) litër;
	- Materiali	➤ Lllamarinë xingato;
	- Përdorimi	➤ Të përshtatshme për mostrim dhe transport të mostrave me natyrë hidrokarbure;
	- Përmasat	➤ ϕ (diametër) = 98-100 mm; ➤ h (lartësi) = 148-150 mm;
	- Forma	➤ Cilindrike;
	- Karakteristika	➤ Në pjesën e sipërme të trupit të ketë dy veshë për vendosjen e shiritit të sekretimit dhe një vesh me tapë. Të jenë të pajisura me nëntapë plastike izoluese kundër rrjedhjes. ➤ Tapa dhe pjesa e sipërme e grykës së enës të jetë minimumi me dy fileto të plota e me guarnicion në mënyrë që të sigurojë një mbyllje të plotë dhe pa rrjedhje. ➤ Gryka e enës të ketë diametër jo më të vogël se 4 cm. ➤ Enët metalike të plotësojnë kushtet sipas standartit S SH EN ISO 3171:2002 “Metodat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës - Marrja automatike e mostrave me tubacion”. (naftë bruto, benzinë, mazut, bitum). ➤ Në trupin e enës të jetë vendosur logo e ISHTI si element identifikimi dhe sigurie. Logo duhet të jetë në trupin e enës, qartësisht e dallueshme, e pamaniplueshme dhe e patjetërsueshme. Logo të jetë rrethore me diametër ϕ (diametri) = 60-80 mm ose drejtkëndore gjerësi 60-80 mm dhe gjatësi 80-100 mm. Formati vektorial si më poshtë me sfond të bardhë për kontrast me enën dhe dallueshmëri.

		 ➤ Enët të jenë të reja, të përdorura dhe të ambalazuara në kuti kartoni ose thasë plastikë.
--	--	---

LOTI 2. ENË PLASTIKE PËR MARRJE MOSTRE KARBURANTI

Emërtimi i artikujve	Specifikime teknike	
Enë/Shishe plastike për marrje mostre karburanti	- Sasi të pritshme	➤ 36,000;
	- Njësia	➤ Copë;
	- Lëvrimi	- sipas Marrëveshjes Kuadër të parashikuar me afat : 24 (njëzet e katër) muaj, nëpërmjet minikontratave të lidhura sipas nevojës me afat lëvrimi 60 ditë;
	- Vëllimi	- 1 (një) litër;
	- Ngjyra	- e zezë;
	- Materiali	➤ Opak për ruajtje të mostrave të ndjeshme ndaj dritës;
	- Përdorimi	➤ Të përshtatshme për mostrim dhe transport të mostrave me natyrë hidrokarbure;
	- Përmasat	➤ ϕ (diametër) = 91-95 mm; ➤ h (lartësi) = 210-215 mm; ➤ Me grykë me diametërtë brendshëm 34-35 mm; ➤ Të graduara me ndarje 100ml;
	- Forma	➤ Cilindrike;
	- Karakteristika	➤ Tapa dhe pjesa e sipërme e grykës së enës të jetë minimumi me dy fileto të plota e me guarnicion në mënyrë që të sigurojë një mbyllje të plotë dhe pa rrjedhje;

		➤ Me tapë me vidhosje (me filetim të brendshëm) dhe me mundësi plumbosje. Teli i plumbosjes të përshkojë si tapën ashtu dhe trupin e enës; ➤ Të ketë nëntapë plastike për të evituar rrjedhjet dhe avullimin; ➤ Në pjesën e sipërme (pranë grykës) ena duhet të jetë në formë konike; ➤ Enët metalike të plotësojnë kushtet sipas standartit S SH EN ISO 3170:2005 “Metodat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës - Marrja e mostrave me dorë.” ➤ Në trupin e enës të jetë vendosur logo e ISHTI si element identifikimi dhe sigurie. Logo duhet të jetë në trupin e enës, qartësisht e dallueshme, e pamanipulueshme dhe e patjetërsueshme. Logo të jetë rrethore me diametër ϕ (diametri) = 60-80 mm ose drejtkëndore gjerësi 60-80 mm dhe gjatësi 80-100 mm. Formati vektorial si më poshtë me sfond të bardhë për kontrast me enën dhe dallueshmëri.  ➤ Enët të jenë të reja, të papërdorura dhe të ambalazuara në kuti kartoni ose thasë plastike.
--	--	---

Argumentimi: Specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor janë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për prokurimin publik si dhe në Regjistrin e Parashikimit të Procedurave të Prokurimit Publik të ISHTI për vitin 2026. Në mënyrë të veçantë, ato mbështeten në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.20220 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe në parashikimet e nenit 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në mënyrë të veçantë, në pikën 1 të nenit 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, parashikohet shprehimisht:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.”

Gjithashtu, në pikën 8 të po këtij neni përcaktohet se:

“8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të

përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve teknike në dokumentet e procedurës është bërë në funksion të objektit të prokurimit dhe në përpjesëtim të drejtë me qëllimin e kontratës, duke synuar garantimin e cilësisë, sigurisë dhe zbatimit korrekt të saj.

Sa i përket kriterit për vëllimin 1 litër ky, përcaktim mbështetet në pikën 3/a të Urdhri i Ministrit Nr. 6, datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse”, ku parashikohet shprehimisht: “3. Sasia e mostrës e nevojshme për kryerjen e analizave e ruajtjen e saj të jetë: a. Për kategorinë 0/A (nafte bruto), II/A, II/B, II/C, III/A, III/C, III/Ç, IV/B. (benzinë automjesh, benzine mjesh të fluturimit ajror, nënprodukte të tjera, të lëngshme si: benzol, toluol, ksilol, solvent, white spirit, gazoil automjesh, lëndë djegëse për mjetet e fluturimit ajror, lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe ose industrial, solar,), V/A, V/B, (bitum, mazut) dhe IV/A (vajrat): - 3 (tre) mostra dhe të shtohet 1 mostër në rastin e importit me kapacitet 1 litër secila, të ambalazhuar në 3 ose 4 mostra mbajtëse, nga të cilat 2 (dy) litra për analizat dhe ruajtje në laborator në ISHP, 1 (një) litër subjektit dhe 1 (një) litër doganës për rastet e importimit para zhdoganimit.” Ky kriter përcakton sasinë e mostrave që duhet të merren për kryerjen e analizave laboratorike dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me standardet teknike përkatëse.

Të gjitha kriteret e vendosura gjejnë mbështetje në pikën 11 të standardit S SH EN ISO 3171:2002 “Metodat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës - Marrja automatike e mostrave me tubacion” dhe pikën 11 të standardit S SH EN ISO 3170:2005 “Metodat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës - Marrja e mostrave me dorë”. Standardi rekomandon përdorimin e shisheve plastike me ngjyrë të zezë, të cilat ndihmojnë në minimizimin e ndërveprimeve të mundshme të lëndës hidrokarbure me faktorët atmosferikë, duke siguruar që mostra të ruajë karakteristikat e saj kimike origjinale dhe të mundësojë analiza të sakta dhe të besueshme.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë të qartë, duke përshkruar karakteristikat e produktit, kërkesat cilësore dhe standardet përkatëse, pa përfshirë asnjë kërkesë apo referencë ndaj ndonjë marke të veçantë, emri tregtar, patente, vizatimi, tipi, origjine specifike, prodhuesi apo sipërmarrësi të caktuar. Për rrjedhojë, ato garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar dhe nuk krijojnë pengesa për konkurrencën e hapur në procedurën e prokurimit publik.

Për ngarkimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik, njësia e prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin.

NJESIA E PROKURIMIT